



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2022:037246  
Datë: 08.10.2024  
Numri i dokumentit: 06268791

**K.Dh.Shk.II.nr.86/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosova, me seli në rr. “Robert Doll”,nr.99 në Prishtinë, kundër debitorëve 1. Sheu Oil me seli në rr. “Xhelal Hajda”, p.nr. në Rahovec, 2. I.Sh. me vendbanim në Rahovec dhe 3. H.Sh. me vendbanim në Rahovec, e përfaqëson me autorizim avokat Emrush Kastrati, me seli në rr. “Nekibe Kelmendi”, kompleksi Liridona në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, KPPP.nr.1791/22, të datës 31.10.2023, me datë 08.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e bazuar ankesa e kreditorit Raiffeisen Bank Kosova, me seli në rr. “Robert Doll”,nr.99 në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, KPPP.nr.1791/22, të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1791/22, të datës 31.10.2023, e ka pranuar si të bazuar propësimin e debitorëve 1. Sheu Oil me seli në rr. “Xhelal Hajda”, p.nr. në Rahovec, 2. I.Sh. me vendbanim në Rahovec dhe 3. H.Sh. me

vendbanim në Rahovec, dhe shfuqizohet urdhrit përbarimor P.nr.15/22, të datës 19.01.2022, të lejuar nga Përmbauesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjës faktike, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, KPPP.nr.1791/22, të datës 31.10.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, dhe të prishet aktvendimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Raiffeisen Bank Kosova, me seli në rr. “Robert Doll”, nr.99 në Prishtinë, ka paraqitur propozim për lejimin e përbarimit, kundër debitorëve 1. Sheu Oil me seli në rr. “Xhelal Hajda”, p.nr. në Rahovec, 2. I.Sh. me vendbanim në Rahovec dhe 3. H.Sh. me vendbanim në Rahovec, e përfaqëson me autorizim avokat Emrush Kastrati, me seli në rr. “Nekibe Kelmendi”, kompleksi Liridona në Prishtinë, në bazë të Marrëveshjes mbi linjën e kredisë nr.200725953 të datës 29.07.2020, shtojcë 1 marrëveshja mbi pengun të datës 29.07.2020 marrëveshja mbi kredinë nr. 200724999 të datës 18.02.2020, shtojcë 1 marrëveshja mbi pengun e datës 18.02.2020 në origjinal dy konfirmime të regjistrimit të pengut nr. R-20200806-414 dhe nr. R-20200220-439 si dhe dokumentet e identifikimit të debitorëve dhe sendeve të lëna peng, për shumën e borxhit prej 53,081.40 €.

Përmbauesi Privat, të lejuar nga Përmbauesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.15/22, të datës 19.01.2022, duke lejuar përbarimin në bazë të Marrëveshjes mbi linjën e kredisë nr.200725953 të datës

29.07.2020, shtojcë 1 marrëveshja mbi pengun të datës 29.07.2020 marrëveshja mbi kredinë nr. 200724999 të datës 18.02.2020, shtojcë 1 marrëveshja mbi pengun e datës 18.02.2020 në origjinal dy konfirmime të regjistrimit të pengut nr. R-20200806-414 dhe nr. R-20200220-439, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit prej 53,081.40 €, me kamatë ligjore deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1791/22, të datës 31.10.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorëve 1. Sheu Oil me seli në rr. “Xhelal Hajda”, p.nr. në Rahovec, 2. I.Sh. me vendbanim në Rahovec dhe 3. H.Sh. me vendbanim në Rahovec, dhe shfuqizohet urdhrit përbarimor P.nr.15/22, të datës 19.01.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret propozimi për përbarim nuk i përmbanë të gjitha elementet e parapara nga nenin 36 paragrafi 1 të LPP-së, në bazë të cilit *"Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri"*. Gjithashtu edhe neni 38 para. 1 i LPP-së ka rregulluar se *"Propozimi për përbarim duhet ta përmbaj kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi (...)"*. Nga këto dispozita rrjedhe se, kreditori në momentin e dorëzimit të propozimit për përbarim të përbaruesi privat duhet ta dorëzoj origjinalin ose kopjen e vërtetuar të dokumentit përbarues. Në këtë drejtim gjykata sqaron se, forma e kopjes së vërtetuar, siç kërkon neni 36 paragrafi 1 dhe neni 38 paragrafi 1 i LPP-së përmbushet vetëm atëherë kur një organ kompetent i caktuar me ligj e vërteton se përmbajtja e kopjes përputhet tërësisht me përmbajtjen e dokumentit në origjinal, respektivisht është identik me origjinalin. Në anën tjetër,

asnjë dispozitë e LPP-së nuk ka parapare përjashtim nga obligimi për dorëzimin e origjinalit ose kopjes së vërtetuar të dokumentit përmbartuesi për institucionet bankare, siç është Kreditori. Si organ kompetent për vërtetimin e kopjes së origjinalit paraqitet noteri i licencuar, siç ka përcaktuar neni 47 i Ligjit 06/L-010 për Noterinë, i cili shprehimisht ka përcaktuar se *"Noteri vërteton vetëm kopjet e dokumenteve origjinale të përgatitura në zyrën e noterit. Noteri mund të vërtetojë gjithashtu kopjet e dokumenteve origjinale të sjellura nga palët për vërtetim, me kusht që kopja e dokumentit të jetë bërë në zyrën e noterit"*, ndërsa në paragrafet tjera e ka rregulluar obligimin e noterit që të jap informacione lidhur me kopjimin. Në rastin konkret dokumentet përmbartuese të dorëzuara nga Kreditori nuk janë kopje të vërtetuara nga noteri. Këtë mangësi e rregullon neni 38 paragrafi 2 i LPP-se, i cili shprehimisht ka urdhëruar se *"Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e çregjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore"*. Më konkretisht rezulton se sipas nenit 43, par. 3 të LPP-së ku përcakton se: *"Përmbartuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbartueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbartueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim"*. Andaj, si e tillë e njëjta mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovimin e prapësimit të debitorëve. Ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës

së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar me nenin 36 paragrafi 1 të LPP-së, në bazë të cilit "*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri*". Gjithashtu edhe neni 38 para. 1 i LPP-së ka rregulluar se "*Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi (...)*". Nga këto dispozita rrjedhe se, kreditori në momentin e dorëzimit të propozimit për përmbarim të përmbaruesi privat duhet ta dorëzojë origjinalin ose kopjen e vërtetuar të dokumentit përmbarues. Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se Marrëveshja mbi linjën e kredisë nr.200725953 të datës 29.07.2020, shtojcë 1 marrëveshja mbi pengun të datës 29.07.2020 marrëveshja mbi kredinë nr. 200724999 të datës 18.02.2020, shtojcë 1 marrëveshja mbi pengun e datës 18.02.2020, mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht dokumentet përmbaruese nuk janë deponuara në origjinal apo kopje të vërtetuar siç kërkohet me ligj.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore lidhur me atë se kontrata e pengut e rregjistruar në regjistrin zyrtar të pengut dhe në këtë rast kemi të bëjmë me peng dhe dokumenti i njejtë e përmbush kushtin e titullit ekzekutiv, i refuzoj si të pa bazuara ngase të njejtat pretendime i ka trajtuar edhe gjykata e shkallës së parë dhe ka dhënë arsyetim të mjaftuar të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**  
K.Dh.Shk.II.nr.86/24 dt. 08.10.2024

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija Ymeri